



J. Y. Parlamentar
te fjetur me 18.07.18
06.23.18



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore

Nr. ____ Prot.

Tiranë më ____/____2018

Lënda: Kërkesë për shtyrjen e afatit të veprimtarisë të Komisionit të Posaçëm Parlamentar "Për Realizimin e Reformës Zgjedhore"

Drejtuar:

Z. Gramoz RUÇI
KRYETAR I KUVENDIT

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Me vendimin Nr. 102/2017, datë 13.10.2017, Kuvendi i Shqipërisë vendosi krijimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar "Për Realizimin e Reformës Zgjedhore".

Në pikën X të këtij Vendimi, parashikohet që Komisioni do të zhvillojë veprimtarinë e tij në një afat kohor 6 mujor nga data e miratimit të këtij vendimi.


Me Vendimin nr. 58, datë 29.03.2018, Kuvendi vendosi zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar Për Reformën Zgjedhore për një periudhë 4 mujore nga data e miratimit të këtij vendimi.


Me qëllim që veprimtaria e këtij Komisioni të Posaçëm Parlamentar të përmbushë të gjithë objektivat e përcaktuara nga Kuvendi, do të nevojitet më shumë kohë sesa u parashikua në vendimin nr. 58/2018.

Për këtë arsye, kërkojmë që në seancë plenare, Kuvendi të shqyrtojë dhe të miratojë projektvendimin bashkëlidhur për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar "Për reformën Zgjedhore" për një periudhë prej gjashtë muajsh.

Me konsideratë,

BASHKËKRYETARËT


Bledi Çuçi

Oerd BYLYKBASHI




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTVENDIM Nr. __/2018

PËR
“ZGJATJEN E AFATIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË POSAÇËM
PARLAMENTAR PËR REALIZIMIN E REFORMËS ZGJEDHORE”

Në mbështetje të nenit 77, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit,
me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

1. Afati i veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore zgjatet për një periudhë 6-mujore nga data e miratimit të këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën __. __. 2018